

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-14



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

	31.12.2016	31.12.2015
AKTIVET	817,126,250	234,897,126
Mjetet monetare	43,969,516	322,406
Të drejta të arkëtueshme :	769,359,497	227,910,400
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	713,556,141	227,910,400
<i>Të tjera te drejta te arketueshme</i>	55,803,357	
Inventarët:		
<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		
<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>		
Shpenzime të shtyra	3,797,237	6,664,320
Aktive financiare:		
<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
Aktivete materiale:		
<i>Toka dhe ndërtesa</i>		
<i>Impiante dhe makineri</i>		
<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>		
DETYRIME DHE KAPITALI	817,126,251	234,897,126
Detyrime afatshkurtra:	780,607,573	223,175,353
<i>Titujt e huamarrjes</i>		14,625,099
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	773,390,511	206,024,657
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	1,744,446	
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	5,472,616	2,175,408
<i>Të tjera të pagueshme</i>	-	350,190
Të ardhura të shtyra	-	
Detyrime totale	780,607,573	223,175,353
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i Nënshkruar		
Primi i lidhur me kapitalin		
Rezerva rivlerësimi		
Rezerva të tjera		
<i>1. Rezerva ligjore</i>		
<i>2. Rezerva statutore</i>		
<i>3. Rezerva të tjera</i>		
Fitimi i pashpërndarë	252,367	
Fitim / Humbja e Vitit	36,266,311	11,721,773
Totali i Kapitalit	36,518,678	11,721,773
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	817,126,250	234,897,125.41



 Dorian Deliallisi (Biba)
 D&D Accounting
 Kontabiliste e Miratuar Çert. Nr.159
 NUIS: L618030320






Pasqyra e Performancës

(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

	2016	2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	1,087,039,194	189,925,334
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		
Shpenzime të personelit	-11,687,014	-1,254,560
1. Paga dhe shpërblime	-8,407,453	-912,299
2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	-1,136,561	-342,262
3. Te tjera shpenzime personeli	-2,143,000	
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	-	-174,803,820
	1,039,056,766	
Të ardhura të tjera	-	
1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		-76,633
Te ardhura/Shpenzime financiare (neto)	6,475,952	
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		
2. Shpenzime të tjera financiare (kursi I kembimit)	6,475,952	
Fitimi/Humbja para tatimit	42,771,366	13,790,321
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-6,505,056	-2,068,548
Shpenzimi i tatimit fitimit të periudhës	-6,505,056	-2,068,548
Fitimi/Humbja e vitit	36,266,311	11,721,773


 Dorianë Deliallisi (Biba)
 D&D Accounting
 Kontabiliste e Miratuar Çert. Nr.159
 NUIS: L61803032D





Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)**L51623028A****Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore 01 Janar-31 Dhjetor 2016**

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 Janar 2015		-	-	-
Shuma te perfituara nga ndarja				-
Transferim në fitimin e mbartur	-			-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			11,721,773	11,721,773
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	-	-	11,721,773	11,721,773
Shuma te perfituara nga ndarja		11,721,773	(11,721,773)	-
Transferim në fitimin e mbartur	-	(11,469,405)		(11,469,405)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			36,266,311	36,266,311
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	-	252,367	36,266,311	36,518,678

g' Deliallisi n' psh

Dorjana Deliallisi (Biba)
D&D Accounting
Kontabiliste e Miratuar Çert. Nr.159
NUIS: L61803032D

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare


(metoda indirekte)

miratjame ne levi per regjistri shprehjet marzoni

	2016	2015
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	48,640,564	399,038
Fitim / Humbja e vitit	42,771,366	13,790,321
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	-12,981,008	-1,991,916
<i>a. Shpenzimet financiare jomonetare</i>	-6,475,952	76,633
<i>b. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	-6,505,056	-2,068,548
Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	18,850,206	-11,399,367
<i>a. Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	-538,582,014	-234,574,720
<i>c. Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme e te tjera</i>	557,432,220	223,175,353
<i>d. Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
<i>a. Para të përdorura për blerjen e filialeve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të blera)</i>		
<i>b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të shitura)</i>		
<i>c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>e. Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
<i>f. Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>g. Dividentë të arkëtuara</i>		
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit	(11,469,406)	-
<i>a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>b. Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>c. Hua të arkëtuara</i>		
<i>d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>e. Riblerje e aksioneve të veta</i>		
<i>f. Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>g. Pagesa e huave</i>		
<i>h. Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>i. Interes i paguar</i>		
Fitim I alokuar	-11,469,406	
Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe eknivalente te mjeteve monetare	37,171,158	399,038
Mjete monetare dhe eknivalente te mjeteve monetare me 1 janar	322,406	
Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare	6,475,952	(76,633)
Mjete monetare dhe eknivalente te mjeteve monetare me 31 dhjetor	43,969,516	322,406

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Doriana Deliallisi (Biba)
 D&D Accounting
 Kontabiliste e Miratuar Çert. Nr. 159
 NUIS: L61803032D



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqeria “**Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)**) është themeluar më dt. në 23/04/2015 bazuar ne Ligjin nr.9723 Prot, dt.03.05.2007 ‘Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit’

Aktiviteti i shoqerise eshte Ndertimi ne Infrastruktura, aktualisht per Projektin ‘Qukes-Qafe Plloce’ Seksioni 2. Ky project financohet 20% (TVSH) nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe 80% nga Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016
Euro/LEK	135.23
USD/ LEK	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.



Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria njihet të ardhurat bazuar në Punime të Certifikuara sipas Kontrates me Punedhënesin. Në rastet kur gjykohet se Përfitime ekonomike do të ndodhin, shoqëria njihet të ardhurat në periudhën e faturimit të brendshëm.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%.



Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me

detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016:

Vlerë monetare në Lekë

31 dhjetor 2016

42.431.476

1,538,040

Banka

Arka

43,969,516



Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)

L51623028A

Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore 01 Janar-31 Dhjetor 2016

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari te arketueshmenë Lekë	
Kliente (Autoriteti Rrugor Shqiptar)	713.556.141
Hua marrje/Huadhenie tregtare	55,803,357
	<u>769,359,497</u>

6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
	<u>3,797,237</u>
Shpenzime të shtyra (prime sigurimi per Kontraten)	
	<u>3,797,237</u>

DETYRIME AFATSHKURTRA

7. TE PAGUESHME PER AKTIVITEIN E SHFRYTEZIMIT

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë	773.390.511
	<u>773.390.511</u>

8. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE DHE SIGURIMEVE

Detyrimet më 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:



Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)**L51623028A****Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore 01 Janar-31 Dhjetor 2016**

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

	<u>31 dhjetor 2016</u>
	1,453,610
Detyrime ndaj/nga personeli	
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	290,836
	<u>1,744,446</u>

9. TË PAGUESHME PER DETYRIMET TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
	1,288,812
Tatim fitimi	4,144,154
TVSH Dhjetor 2016	39,650
Tatim mbi te ardhurat personale	
	<u>5,472,616</u>



10. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:
Shifra e Afarizmit perputhet me Te ardhurat e deklaruar ne Bilanc. Shuma e te Ardhurave eshte gjeneruar nga Punimet e kryera per projektin Qukes-Qafe Plloce, bazuar ne fatura tatimore Shitje

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
	1,087,039,194
Punime te kryera ne projektin Qukes-Qafe Plloce	
	<u>1,087,039,194</u>

11. TE ARDHURA FINANCIARE

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Te ardhura nga Kursi I kembimit (net)	6,475,952



Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)**L51623028A****Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore 01 Janar-31 Dhjetor 2016***Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe*

6,475,952

12. SHPENZIME TE TJERA SHFRYTEZIMI

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e punimeve (Blerje punime me nenkontraktim)	1.035.493.501
Sigurim Kontrate	2,531,491
Te tjera rrjedhese	264.963
Taksa & Tarifa vendore	101,000
Konsulenca & sherbime	665.810
	1,039,056,766

13. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	8,407,453
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,136,561
Dieta per personelin	2,143,000
	11,687,014

14. SHPENZIMET FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Te ardhura nga Kursi i kembimit (net)	0




Combined Group Contracting Company K.S.C (dege e shoqerise se huaj)**L51623028A****Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore 01 Janar-31 Dhjetor 2016**

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

0

15. TATIMI MBI FITIMIN

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
	42,771,366
<i>Fitimi para tatimit</i>	
Shpenzime të panjohura	595,671
	43,367,037
<i>Fitimi I tatueshem</i>	
<i>Tatim fitimi 15%</i>	6,505,056
	36,266,311
Fitimi neto	

27. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINCIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.



Doriana Deliallisi (Biba)
D&D Accounting
Kontabiliste e Miratuar Çert. Nr.159
NUIS: L61803032D

